



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 nëntor 2015  
Nr. ref.: RK 858/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI69/15**

Parashtrues

**Enver Krasniqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të  
Kosovës, Rev. nr. 305/2014, të 8 dhjetorit 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Enver Krasniqi nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 305/2014, të 8 dhjetorit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), i cili i është dorëzuar parashtruesit më 18 shkurt 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 305/2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 29 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI69/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI69/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 22 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 13 gusht 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon datën kur parashtruesi ka pranuar Aktvendimin (Rev. nr. 305/2014) e Gjykatës Supreme, të 8 dhjetorit 2014.
9. Më 28 gusht 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin shtesë të kërkuar nga Gjykata.
10. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 26 prill 2005, Ministria e Shërbimeve Publike, me vendim (06/2005), emëroi parashtruesin ushtrues të detyrës së Sekretarit të Përhershëm.

12. Më 5 maj 2006, Sekretariati i Komisionit për Emërime të Larta Publike (në tekstin e mëtejme: KELP) njoftoi parashtruesin se është zgjedhur në pozitën e Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Shërbimeve Publike.
13. Më 3 korrik 2006, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë (nr. 020) të marrëdhënies së punës në pozitën e Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Në kontratë theksohej se *“kontrata hyn në fuqi pas kalimit të periudhës së punës provuese prej tre muajsh”*.
14. Më 4 gusht 2006, KELP, me vendim (nr. 032/2006), emëroi parashtruesin në pozitën e Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shërbimeve Publike.
15. Më 10 gusht 2006, Ministria e Shërbimeve Publike dhe këshilltarët e saj mbajtën takim me parashtruesin e kërkesës, në të cilin parashtruesit të kërkesës i tregohen parregullsitë në punë. Në këtë takim, parashtruesi i kërkesës është njoftuar se Ministria do t'i rekomandojë KELP-së ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës.
16. Më 17 gusht 2006, Ministria e Shërbimeve Publike me rekomandim (nr. 3111) i kërkoi KELP-it ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës.
17. Më 21 gusht 2006, KELP, me vendim (nr. 042/2006), shkëputi marrëdhënien e punës së parashtruesit në pozitën e Sekretarit të Përhershëm. Në pikën dy të këtij Vendimi konstatohet se *“kontrata e lidhur ndërmjet KELP dhe parashtruesit shkëputet gjatë periudhës provuese të cekur në kontratë”*.
18. Më 25 gusht 2006, parashtruesi ushtroi ankesë në KELP kundër Vendimit 042/2006, të 21 gushtit 2006.
19. Më 3 shkurt 2009, parashtruesi iu drejtua me një shkresë KELP-it dhe kërkoi sqarim se përse nuk ka marrë përgjigje për ankesën e tij në periudhë kohore prej 2 (dy) vjetësh.
20. Më 17 mars 2009, parashtruesi parashtrroi padi për kompensimin e dëmit dhe për kthim në vend të punës në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
21. Më 25 maj 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin (C nr. 565/09) refuzoi, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit me arsyetimin:
 

*“... Nga provat e paraqitura e paditura e ka vërtetuar bazën juridike të ndërprerjes së kontratës së punës para skadimit të afatit të paraparë në kontratë dhe mbi këtë bazë gjykata vlerëson se vendimi i KELP, si organ i të paditurës, nr. 042/06 dt: 21.08.2006, mund të konsiderohet si i ligjshëm...”*
22. Më 7 janar 2013, parashtruesi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit (C nr. 565/09) të Gjykatës Komunale.
23. Më 18 prill 2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin (Ac. nr. 796/2013) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin (C nr. 565/09) e Gjykatës Komunale me arsyetimin:

*“Është vlerësim edhe i Gjykatës së Apelit se, në situatën konkrete punën e punonjësit dhe performancën e tij e vlerëson vet punëdhënësi, ndërsa një gjë e tillë në asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar se e bënë gjykata. Meqë, sipas vlerësimit të vet Ministres ka rezultuar se, paditësi' që në fillim të punës së tij nuk ka kryer punën si duhet, atëherë edhe me të drejtë ka ardhur deri 'te ndërprerja' e kësaj pune, pa e pritur përfundimin e punës provuese”.*

24. Më 24 qershor 2014, parashtruesi ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit (Ac. nr. 796/2013) të Gjykatës së Apelit.
25. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata Supreme me Aktvendimin (Rev. nr. 305/2014) pranoi si pjesërisht të bazuar kërkesën për revizion dhe ndryshoi Aktgjykimin (Ac. nr. 796/2013) e Gjykatës së Apelit, si dhe hodhi poshtë padinë e parashtruesit *“lidhur me kthimin në vend të punës dhe kompensimin e dëmit”*.
26. Në Aktvendimin e saj Gjykata Supreme konstatoi se Aktgjykimi (Ac. nr. 796/2013) i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi (C nr. 565/09) i Gjykatës Komunale janë nxjerrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e vlerësimit të padisë së parashtruesit lidhur me afatin e ushtrimit të padisë.
27. Për më tepër, Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padinë *“lidhur me kthimin në vend të punës dhe kompensimin e dëmit”* jashtë afatit kohor të paraparë me ligj.

### **Pretendimet e parashtruesit**

28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të anulohet vendimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 305/2014), për arsye se ka shkelur të drejtën nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nga neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].
29. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme gabimisht ka konkluduar se *“në rastin konkret kemi rast të kontestit të punës dhe të marrëdhënies së punës”* dhe se *“baza ligjore e kërkesës ishte kompensimi i dëmit për shkak të veprimeve të kundërligjshme të zyrtarëve të organeve shtetërore apo organeve të tyre dhe rrjedhimisht në rastin e vendosjes është dashtë të aplikohen dispozitat e LMD-së që rregullojnë këtë lami”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
31. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës:
32. Neni 48 i Ligjit, parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

33. Përveç kësaj, rregulli 36 i Rregullores së punës, parasheh:

*(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme gabimisht ka aplikuar të drejtën procedurale dhe se aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në bazë të Ligjit të punës, dhe se kërkesëpadia e tij ishte në lidhje me kompensimin e dëmit, andaj ishte e nevojshme të aplikohet Ligji për marrëdhëniet detyrimore.

35. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se me një aplikim të tillë të të drejtës materiale i janë shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta për punë dhe kryerje të profesionit, të garantuara me Kushtetutë.

36. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se këto pretendime të parashtruesit janë në kundërshtim me dokumentacionin që ai i ka dorëzuar Gjykatës.

37. Nga dokumentacioni i parashtruar mund të konkludohet se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës me Vendimin e KELP (nr. 042/2006) *“në periudhën e punës provuese të caktuar në kontratë”.*

38. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me Aktvendimin (Rev. br. 305/2014) hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, dhe arsyetoi se si parashtruesi i kërkesës është dashur të mbrojë të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës:

*“... Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës... është parashikuar që punëtori i pakënaqur... nëse ky organ nuk merr vendim në afat prej 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës apo kundërshtimit, punëtori ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e drejtave të veta para gjykatës kompetente”.*

39. Gjykata Supreme, më tej ka konkluduar: *“Në rastin konkret nuk janë plotësuar presupozimet procedurale... për faktin se paditësi për mbrojtjen e të drejtave të cenuara nuk i është drejtuar gjykatës në afatin e përcaktuar ligjor me dispozitën e nenit 83 të Ligjit për të drejtat themelore nga marrëdhënia e*



*punës. Këtë për faktin se paditësi kundër vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës ... ka paraqitur ankesë Komisionit për Emërime të Larta më dt. 25.08.2006 ... ndërsa padinë për mbrojtjen e të drejtave të cenuara ka paraqitur gjykatës më 19.03.2009 (pas 2 vite e 7 muaj pas paraqitjes së ankesës). Ky afat është prekluziv që do të thotë se me kalimin e tij humb edhe e drejta...“.*

40. Nga sa u tha më lart, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit për kompensim të dëmit bazohet në të drejtat e parashtruesit që burojnë nga kontrata e tij e punës.
41. Duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se kontrata e tij e punës është ndërprerë në mënyrë të paligjshme, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aplikim të gabueshëm të së drejtës procedurale dhe “*veprimtarinë e paligjshme të zyrtarëve të organeve shtetërore*“ janë në kundërshtim me dokumentacionin që ai i ka dorëzuar Gjykatës.
42. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur, kryesisht, me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të ligjshmërisë.
43. Gjykata konsideron se procedurat para Gjykatës Komunale, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ishin të drejta dhe se vendimet janë të justifikuara në tërësi dhe të arsyetuara në hollësi, pa marrë parasysh aplikimin e ndryshëm të të drejtës procedurale dhe asaj materiale.
44. Pra, Gjykata Kushtetuese konkludon se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991; dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).
45. Faktikisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie *prima facie*, e cila do të tregonte për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, vendimi i 31 majit 2005) dhe nuk ka precizuar se si nenet e Kushtetutës, të cilëve iu referohet, mbështesin pretendimet e tij, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
46. Për më tepër, Gjykata rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose organeve tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

47. Pra, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për punë dhe kryerje të profesionit.
48. Si përfundim, Gjykata konsideron, se sipas nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara, prandaj kërkesa është e papranueshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 tetor 2015, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi